

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Nr. i regjistrimit themeltar 825

Date e regjistrimit 03.05.2012

Data e vendimit 04.05.2012

VENDIM

“PËR VENDOSJE TË SEKUESTROS PREVENTIVE”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga:

GJYQTARE: ELDA VRIONI

Asistuar nga sekretarja gjyqesore Ornela Dodaj, në Tiranë, datë 04.05.2012, shqyrtoi kërkesën që i përket:

KËRKUES: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Tiranë përfaqësuar nga prokuror **Ndini Tavani**.

OBJEKTI: Vendosje e sekuestros preventive për procedimin penal nr.2103 të vitit 2012.

BAZA LIGJORE: Neni 36 i Kodit Penal dhe neni 274, pika 2 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata, pasi dëgjoi prokurorin që kërkoi pranimin e kërkesës, dhe pasi shqyrtoi materialin procedues,

VËREN

Nëpërmjet kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Tiranë, depozituar në Gjykatë në datën 03.05.2012, kërkohet të vendoset sekuestro preventive për te gjitha asetet financiare (shuma në para) të shtetasve (.....) dhe (.....), të ndodhura në llogaritë e tyre në bankat: Intesa San Paolo, Tirana Bank, Banka Credins dhe Union Bank.

Nga aktet shoqëruese të kërkesës si dhe parashtrimet e prokurorit të çështjes, rezulton sa më poshtë:

në datë 02.05.2012, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka regjistruar procedimin penal Nr.2103, për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale”, veprë penale kjo e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Shtetasi (.....), i datëlindjes (.....), banues në Tiranë, rezulton nga të dhënat e materialeve të para hetimore se disponon në llogari të ndryshme në banka të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë, shuma te konsiderueshme parash te depozituara kryesisht në valute të huaj (euro) përkatësisht:

1. më datë 21.08.2009, ka kredituar në llogarinë e tij në Bankën San Paolo shumën (.....) euro;
2. më datë 16.08.2010 ka kredituar në Union Bank, shumën (.....) euro;
3. më datë 23.08.2010 ka kredituar në llogarinë e tij në Tirana Bank shumën (.....) euro, duke e ripërtëritur në vitin 2011;
4. më datë 29.08.2011, ka kredituar në llogarinë në emër të tij në Union Bank shumën (.....) euro;
5. më datë 29.12.2011, ka kredituar në një llogari në emër të tij, në Banken Credins shumën (.....) euro.

Shtetasi (.....), i datëlindjes 15.05.1951, i cili është i ati i shtetasit (.....), rezulton nga të dhënat e materialeve të para hetimore, se në llogari të ndryshme në banka të nivelit të dytë në Republikën e Shqipërisë, gjithashtu ka depozituar shuma të konsiderueshme parash te depozituara kryesisht në valutë të huaj euro përkatësisht:

6. më datë 01.09.2009 ka kredituar në një llogari në emër të tij në bankën Intesa San Paolo shumën prej (.....) euro;
7. më datë 01.09.2010, ky shtetas ka kryer dy transfertë, një në shumën (.....) euro në llogarinë e tij dhe shumën prej (.....) në llogarinë e bashkëshortes - shtetasës (.....).

Pretendimet e sipërcituara, mbështeten edhe në shkresat respektive të bankave të nivelit të dytë, përkatësisht Intesa San Paolo, Tirana Bank, Banka Credins dhe Union Bank.

Nga aktet rezultoi se më datë 16.04.2012, në shtetin italian është arrestuar shtetasi (.....), i cili rezulton të jetë vëllai i shtetasit (.....) dhe djali i shtetasit (.....).

Nga ana e organit të akuzës, është pretenduar se veprimet e shtetasve (.....) dhe (.....) janë kryer për fshehjen, mbulimin e origjinës së pasurisë, mbulimin e natyrës, burimit, vendndodhjes së parave që rezulton dhe ka të dhëna të mjaftueshme se janë produkt i veprës penale të konsumuara në shtetin Italian nga shtetasi (.....).

Sipas nenit 274 të Kodit të Procedurës Penale, pika 2: *‘Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar..’*

Në analizë të akteve shkresore, gjykata, në përfundim të shqyrtimit të kërkesës, arrin në përfundimin se plotësohen kushtet dhe kriteret ligjore të përcaktuara në nenet 274/2 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 36 pika 1, germa ‘ç’ të Kodit Penal, për vendosjen e sekuestros preventive mbi të gjitha asetet financiare (shuma në para) të shtetasve (.....)

dhe (.....), të ndodhura në llogaritë e tyre në bankat Intesa San Paolo, Tirana Bank, Banka Credins dhe Union Bank.

PËR KËTO ARSYE

Konform nenit 274/2 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 36 të Kodit Penal

VENDOSI

8. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
9. Vendosi e sekuestros preventive për të gjitha asetet financiare (shuma në para) të shtetasve (.....) dhe (.....) të ndodhura në llogaritë e tyre në bankat Intesa San Paolo, Tirana Bank, Credind dhe Union Bank.
10. Ngarkohen Oficerët e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Kundër Krimit Financiar në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
11. Kundër vendimit lejohet ankim sipas ligjit, në Gjykatën e Apelit Tiranë.

–U shpall në Tiranë, sot më datë 04.05.2012.

SEKRETARE

ORNELA DODAJ

GJYQTARE

ELDA VRIONI